



# KONFERENCA *Diaspora Flet*

Këln, Gjermani, 7-9 nëntor 2025

## RAPORT ME REKOMANDIME





## **RAPORT ME REKOMANDIME**

Mars 2026

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Konferenca Diaspora Flet 2025, e mbajtur nga 7 deri më 9 nëntor 2025 në Këln, Gjermani, shënoi një etapë të rëndësishme në avancimin e angazhimit të diasporës për komunitetet shqipfolëse dhe më gjerë. E organizuar bashkërisht nga GERMIN dhe GIZ – MEG, konferenca shërbeu si një platformë strategjike për nxitjen e mësimit ndërkulturor, shkëmbimin e njohurive dhe përforcimin e bashkëpunimit ndërmjet diasporave.

Edicioni i vitit 2025 shënoi herën e parë që konferenca *Diaspora Flet* u organizua në Gjermani – vend që strehon komunitetin më të madh të diasporës shqipfolëse në Evropë – duke reflektuar një zgjerim të rëndësishëm të konferencës. Ky edicion shënoi kalimin e konferencës nga një iniciativë kryesisht kombëtare në një platformë ndërkombëtare shkëmbimi dhe bashkëpunimi ndërmjet diasporave të ndryshme.

### Arritjet kryesore

- Gjithsej 159 pjesëmarrës morën pjesë në konferencë përgjatë tri ditëve të sesioneve;
- 39 folës kontribuan përmes fjalimeve kryesore, paneleve të diskutimit, prezantimeve dhe moderimit;
- Mbi 50 pjesëmarrës nga organizata, institucione dhe kompani të ndryshme;
- 20 organizata të diasporës shqipfolëse me bazë në Gjermani;
- Pjesëmarrje e organizatave të diasporës nga Nepali, Etiopia, Afganistani, Gjermani–Ekuadori, Ukraina dhe Gana.
- Prani dhe angazhim institucional nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës e Kosovës, Agjencia Kombëtare e Diasporës, GIZ/MEG Zyra Qendrore, si dhe përfaqësues të institucioneve gjermane nga North Rhine-Westphalia.

Rezultatet e anketës nga 71 të anketuar tregojnë se:

**81%** e pjesëmarrësve u shprehën shumë të kënaqur

Vlerësimi mesatar i sesioneve **4.30/5** (interval: 3.88–4.46)

**92.96%** vlerësuan mundësitë për rrjetëzim si “të mira” ose “shumë të mira”

**73.24%** krijuan kontakte të reja që mund të rezultojnë me bashkëpunime

---

## Rezultatet Kryesore

- Forcimi i lidhjeve ndërmjet organizatave të diasporës shqipfolëse në të gjithë Gjermaninë;
- Vendosja e lidhjeve ndërkombëtare ndërmjet diasporave, në kuadër të bashkëpunimit me vendet partnere të MEG-it;
- Rritja e ndërgjegjësimit mbi mundësitë e financimit institucional për iniciativa të diasporës;
- Interes i konsiderueshëm për bashkëpunime të mëtejshme, i shprehur përmes nismave dhe kontakteve pasuese.

Diaspora Flet 2025 kontribuoi në mënyrë të konsiderueshme në avancimin e objektivave të programit MEG, përmes:

- Nxitjes së angazhimit të diasporës të orientuar drejt zhvillimit;
- Promovimit të mësimit ndërkulturor ndërmjet komuniteteve të diasporës;
- Forcimit të partneriteteve institucionale;
- Rritjes së kapaciteteve të organizatave të diasporës.

Raporti përmbyllet me mësimet e nxjerra dhe rekomandime konkrete për edicionet e ardhshme të konferencës.

---

## TABELA E PËRMBAJTJES

|                                                                         |    |
|-------------------------------------------------------------------------|----|
| 1. RRETH DIASPORA FLET 2025 .....                                       | 5  |
| 1.1 Përshkrim i përgjithshëm.....                                       | 5  |
| 1.2 Pse Gjermania 2025 .....                                            | 5  |
| 2. PIKAT KRYESORE TË PROGRAMIT (SIPAS DITËVE).....                      | 6  |
| Dita 1 - Kultura, identiteti dhe shkëmbimi ndërkulturor.....            | 7  |
| Dita 2 – Shkëmbimi i njohurive, teknologjia, integrimi dhe arsimi ..... | 10 |
| Dita 3 – Seancë Institucionale (e mbyllur).....                         | 13 |
| 3. REZULTATET DHE NDIKIMI.....                                          | 14 |
| 3.1 Rezultatet (Sasiore) .....                                          | 14 |
| 3.2 Rezultatet e menjëhershme (Cilësore).....                           | 14 |
| 4. PËRSHTYPJET E PJESËMARRËSVE (Të dhënat nga anketa).....              | 15 |
| 4.1 Rezultatet nga Anketa.....                                          | 15 |
| 4.2 Vlerësimi cilësor.....                                              | 15 |
| 4.3 Dëshmi (Testimonials).....                                          | 16 |
| 5. SFIDAT DHE MËSIMET E NXJERRA.....                                    | 18 |
| 5.1 Mësimet Operacionale.....                                           | 18 |
| 5.2 Mësimet programatik.....                                            | 19 |
| 6. FOTOGRAFI .....                                                      | 20 |
| 7. REKOMANDIMET .....                                                   | 21 |
| 8. KONKLuzionET.....                                                    | 28 |
| 9. BURIMET DHE LINQET.....                                              | 29 |

---

## 1. RRETH DIASPORA FLET 2025

### 1.1 Përshkrim i përgjithshëm

Diaspora Flet është një nga platformat kryesore të avokimit dhe bashkërendimit të GERMIN, e konceptuar për të lidhur komunitetet e diasporës shqiptolëse me institucionet e vendeve të origjinës dhe partnerë ndërkombëtarë. E lansuar në vitin 2018, konferenca ka evoluar në një forum me ndikim të lartë, ku akterë të diasporës, qeveri, organizata të shoqërisë civile dhe organizata ndërkombëtare shkëmbejnë ide dhe bashkëkrijojnë zgjidhje për çështje me interes të përbashkët.

### 1.2 Pse Gjermania 2025

Edicioni i vitit 2025 përfaqëson një zgjerim strategjik të konferencës, në përputhje me objektivat globale të programit GIZ Shaping Development-Oriented Migration (MEG). I mbajtur në Këln, ky edicion shfrytëzoi rolin e Gjermanisë si një qendër kyçe për komunitetet shqiptolëse, duke krijuar një mundësi unike për të bashkuar në një hapësirë të përbashkët organizata të diasporës nga disa vende partnere të MEG-it.

Ky raport synon të:

- Ofrojë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të procesit të planifikimit, zbatimit dhe rezultateve të konferencës;
- Paraqesë vlerësimet e pjesëmarrësve, si dhe gjetjet nga monitorimi dhe vlerësimi;
- Dokumentojë mësimet e nxjerra dhe rekomandimet për edicionet e ardhshme.

Raporti është strukturuar në përputhje me standardet e raportimit të orientuar drejt rezultateve të GIZ-it, duke theksuar kriteret e relevancës, efikasitetit, efektivitetit, ndikimit, qëndrueshmërisë dhe mësimave të nxjerrura.



---

## 2. PIKAT KRYESORE TË PROGRAMIT (SIPAS DITËVE)

### Dita 1 – Kultura, identiteti dhe shkëmbimi ndërkulturor

- Mirëseardhje dhe fjalimet kryesore nga::
  - Ali Salihu, Kryetar, URACult e.V. Köln
  - Zethane Berisha, URACult e.V. Köln
  - Agon Kamberi, OASA e.V. Berlin
  - Muhamet Idrizi, ODA e.V. Hamburg
  - Velime Qarri, Shoqëria Dijs e.V. Mynih
  - Fatbardh Veseli, HorizontAL e.V. Frankfurt
  - Lirim Krasniqi, Bashkëdrejtor Ekzekutiv, GERMIN
- Paneli mbi temën “Kultura si urë lidhëse – identiteti, integrimi dhe ndikimi”
- Performanca artistike nga artistë të diasporës, Gert Kapo dhe Epaminondas Ladas





---

**Do të gjeni një përmbledhje të secilit panel. Klikoni mbi tituj për t'u ridrejtuar te videot e plota.**

### **Përmbledhje e panelit “Kultura si urë lidhëse – Identiteti, integrimi, and ndikimi”**

Si përjetohet dhe shprehet identiteti i origjinës në diasporë?

Si mund të kontribuojnë arti, media dhe trashëgimia kulturore në mbështetjen e integritetit në shoqërinë pritëse? Dhe a është “normale” të jetosh mes dy botëve — asaj të origjinës dhe asaj të vendbanimit — pa i përkatur plotësisht asnjërës?

Këto pyetje u eksploruan në panelin “Kultura si urë lidhëse – identiteti, integrimi dhe ndikimi”, ku folës me përvojë ndanë perspektivat e tyre mbi mënyrën se si arti dhe kultura shndërrohen në ura natyrore për ruajtjen e rrënjëve kulturore, për kontribut në shoqëritë pritëse dhe për ndërtimin e hapësirave bashkëpunuese që lidhin kultura të ndryshme.

Paneli u moderua nga Sabina C. nga URACult e.V. dhe hapi zyrtarisht Konferencën Diaspora Flet më 7 nëntor në Këln, duke ofruar një diskutim të thelluar, reflektues dhe me vlerë të lartë për audiencën. Pjesë e këtij paneli ishin Lindita Arapi, gazetare dhe autore nga Boni; Mimoza Velu, fotografe dhe autore nga Berlioni; Nermina Kukić, aktore nga Dyseldorfi; si dhe Shuk Orani, artist multimedial nga Hamburgu. Përvojat e tyre të larmishme i dhanë diskutimit një dimension frymëzues dhe nxitës për reflektim, duke theksuar fuqinë e kulturës si mjet lidhës ndërmjet identitetit, integritetit dhe ndikimit shoqëror.





---

## 2 – Shkëmbimi i njohurive, teknologjia, integrimi dhe arsimi

### Paneli 1: Rrjetëzimi, shkathtësitë dhe shkëmbimi i njohurive

Paneli tematik “Rrjetëzimi, shkathtësitë dhe shkëmbimi i njohurive”, i mbajtur në kuadër të konferencës “Diaspora Flet” 2026, theksoi rëndësinë e nxitjes së bashkëpunimit profesional dhe akademik ndërmjet diasporës dhe institucioneve në vendet e origjinës.

Gjatë tri ditëve të konferencës diskutimet vënë në pah faktin se sot shtetet janë në garë të vazhdueshme për talente. Kapitali intelektual dhe profesional është shëndërruar në një nga burimet më të çmuara në nivel global — një burim që edhe vendet më të zhvilluara e kanë gjithnjë e më të vështirë ta ruajnë në sasi të mjaftueshme.

Për shtetet më të vogla, si i yni, kjo sfidë është edhe më e madhe: aftësia për të tërhequr dhe mbajtur individët më të kualifikuar dhe më të talentuar është natyrshëm e kufizuar. Në këtë kontekst, ne kemi fatin të kemi një diasporë që mishëron një potencial të jashtëzakonshëm intelektual dhe profesional; megjithatë, sfida qëndron në krijimin e rrugëve dhe mundësive për ta kanalizuar këtë potencial në mënyrë efektive.

Kjo temë u trajtua gjatë panelit të parë, ku studiues nga diaspora dhe përfaqësues të institucioneve nga vendet e origjinës diskutuan mënyra konkrete për të nxitur shkëmbimin profesional dhe akademik ndërmjet komuniteteve të diasporës dhe institucioneve amë.

Paneli u moderuar nga Dr. Eshref Januzaj (DIJA e.V.), ndërsa pjesë e tij ishin Dr. Lisana Berberi (Instituti i Teknologjisë Karlsruhe), Dr. Ilir Gedeshi (CESS Tirana), Dr. Carolin Leutloff-Grandits (Universiteti Evropian i Viadrinës) dhe Dr. Gentrit Berisha (Universiteti i Prishtinës), të cilët ofruan reflektime të vlefshme mbi forcimin e bashkëpunimit ndërmjet akademisë, institucioneve dhe profesionistëve të diasporës.



---

## Paneli 2: Përvoja krahasuese ndërkombëtare

Paneli “Përvoja krahasuese të projekteve të suksesshme të diasporës” dëshmoi se bashkëpunimi, e jo-konkurrenca, është shtytësi kryesor i progresit.

I moderuar nga Bahri Cani (gazetar dhe influencer, Bonn), sesioni mbledhi së bashku:

Alexander Kusnezow (IBZ Bielefeld e.V.), Julia Chenusha, LL.M. (DUWir gGmbH), Martina Lartey (AiDiA), Agon Kamberi (OASA e.V. Berlin) dhe Ashish Pokhrel (Nepali Samaj) — drejtues projektesh të mbështetura nga GIZ/MEG (Shaping Development-Oriented Migration).

Përvojat e tyre dëshmuar një të vërtetë thelbësore: në angazhimin e diasporës, modelet dhe akterët e suksesshëm nuk garojnë mes vete — ata ndajnë përvojat. Ne mësojmë, përshtasim dhe replikojmë atë që funksionon. Pikërisht kështu Diaspora Flet shndërrohet nga një konferencë në një platformë globale shkëmbimi për dije, frymëzim dhe ndikim.





---

### Paneli 3: Teknologji dhe Inovacion – Lidhja e tregjeve dhe ekosistemeve

Në një botë ku talenti dhe teknologjia nuk njohin kufij, lidhja nuk është më luks — është domosdoshmëri.

Kjo ide u theksua qartësisht në panelin “Teknologjia & Inovacioni – Lidhja e Tregjeve dhe Ekosistemeve” në DiasporaFlet2025, ku folësit shqyrtuan mënyrat se si inovacioni mund të kapërcejë distancat mes vendeve të origjinës dhe diasporës.

I moderuar nga Dr. Fatbardh Veseli (HorizontAL e.V.), diskutimi mbledhi një panel frymëzues: Agnesa Belegu (Maxis Studios – Electronic Arts, Berlin), Gazmend Selmani, MBA (CEO i IBAS World, Londër), Genc Rama (Deutsche Post AG, Këln) dhe Fitim Adili (Zhvillues Software-sh, Hamburg).

Paneli vuri në pah se si nismat e udhëhequra nga diaspora po nxisin ndryshime konkrete — nga ndërtimi i ekosistemeve të qëndrueshme teknologjike dhe lidhja e tregjeve, te zgjerimi i partneriteteve globale dhe përsheptimi i transformimit digjital në vendet e origjinës.

Siç u theksua nga disa prej folësve, pas çdo hapi teknologjik qëndron një histori njerëzore — një histori përkatësie, inovacioni dhe bashkëpunimi.



---

#### Paneli 4: Edukimi dhe mësimi i gjuhës

Paneli “Edukimi dhe Integrimi: Roli i Mësimi të Gjuhës së Trashëgimisë në Komunitetet e Diasporës” ngjalli interes të madh te publiku në DiasporaFlet2025.

Mësimi i gjuhës shqipe për komunitetin shqiptar jashtë vendit mbetet një nga çështjet më të rëndësishme — por edhe më sfiduese. Megjithëse kjo temë trajtohet dhe merr vëmendje, deri më sot nuk ka pasur ndryshime strukturore që do të garantonin vazhdimësi dhe cilësi në mësimdhënie. Në shumicën e rasteve, mësuesit angazhohen në baza vullnetare, ndërsa pjesëmarrja e nxënësve mbetet e ulët edhe aty ku ofrohen klasa plotësuese.

Kjo temë, e cila nuk prek vetëm komunitetin shqiptar por edhe komunitete të tjera të diasporës, mori një dimension më të gjerë përmes kontributit të Mostapha Bouklouâ, Drejtor i Divizionit “Integrimi përmes Arsimit” në Ministria e Arsimit e Nordrhein-Westfalen (NRW), i cili ndau mundësitë që ofron shteti gjerman për mbështetjen e mësimi të gjuhëve amtare, përfshirë edhe gjuhën shqipe.

Paneli u moderua nga Muhamet Idrizi (ODA e.V., Hamburg), kurse pjesë e diskutimit ishin: Prof. Dr. Tonin Gjuraj (Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër) – i cili prezantoi planin për themelimin e një programi master profesional për mësues të gjuhës shqipe, që do të certifikohet nga Universiteti i Shkodrës; Negmije Reçica (Presidente, Këshilli i Mësuesve Shqiptarë në Gjermani) – e cila ndau sfidat që lidhen me organizimin dhe bashkëpunimin institucional; Milazim Ukaj (Kryetar, Shkolla Shqipe “LAPSH Bavaria”) – i cili theksoi se puna e tyre mbështetet pothuajse tërësisht në baza vullnetare dhe se, falë përkushtimit të mësuesve, mësimi i gjuhës shqipe vazhdon, ndonëse pjesëmarrja në landin e Bavarisë mbetet e ulët.

Ky panel ofroi një reflektim të thellë mbi rëndësinë e gjuhës amtare si një urë lidhëse mes brezave, identitetit dhe integritetit.





---

## Mbrëmje kushtuar programit OriginAL

Gjatë konferencës Diaspora Flet, një mbrëmje iu kushtua programit OriginAL — një nismë që forcon lidhjen me rrënjët për të rinjtë në diasporë.

Alumni nga pesë gjenerata, nga Gjermania dhe vende të ndryshme të Evropës, ndanë histori personale, lidhje të reja dhe ndikimin afatgjatë që OriginAL ka pasur në jetën e tyre. Gjermania renditet tashmë e dyta për nga numri i aplikantëve dhe alumnive.

Për shumë anëtarë të komunitetit shqiptar në Gjermani, ky program u prezantua për herë të parë. Ndër të tjera, një prind ndau gjithashtu se si OriginAL ka ndikuar jo vetëm te fëmija i tij, por te e gjithë familja, duke thelluar ndjenjën e përkatësisë dhe komunitetit.



---

### Day 3 – Seancë Institucionale

Seanca institucionale e mbyllur mbledhi organizata të diasporës shqiptare, së bashku me institucione kyçe nga Kosova dhe Shqipëria, me synimin për të thelluar bashkëpunimin dhe për të forcuar koordinimin ndërinstitucional. Seanca u hap me prezantimet e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës së Kosovës, nga Elis Badalli, Drejtor i Departamentit për Diasporë, të pasuara nga sesioni i pyetjeve dhe diskutimi i hapur. Më pas, u mbajt prezantimi nga Drejtoresha Ekzekutive e Agjencisë Kombëtare të Diasporës Shqiptare, Ermonela Xhafa, gjithashtu i pasuar nga pyetje dhe diskutim i hapur.

Prezantimet theksuan arritjet kryesore të institucioneve dhe iniciativat të vazhdueshme, duke u ofruar pjesëmarrësve një pasqyrë më të qartë mbi prioritetet aktuale dhe fushat e veprimit që lidhen me angazhimin e diasporës. Duke u mbështetur në këtë përmbledhje, diskutimi u orientua drejt identifikimit të mënyrave konkrete për përmirësimin e bashkëpunimit me organizatat e diasporës shqiptare dhe rritjen e mbështetjes institucionale nga vendet e origjinës.

Një theks i veçantë iu kushtua përmirësimit të komunikimit dy anshëm, duke siguruar që informacionet, mundësitë dhe përditësimet të shpërndahen më rregullisht dhe në mënyrë më të qasshme. Poashtu krijimit të kanaleve të besueshme përmes të cilave organizatat e diasporës të mund të komunikojnë drejtpërdrejt me institucionet për nevojat, vërejtjet dhe propozimet e tyre. Pjesëmarrësit nënvizuan gjithashtu rëndësinë e qartësisimit të procedurave dhe kriterëve të përfitimit, përfshirë udhëzime më të qarta mbi mekanizmat e mbështetjes në dispozicion, proceset e aplikimit, pikat e kontaktit dhe kriteret e pjesëmarrjes.

Po ashtu, diskutimi vuri në pah rëndësinë e një qasjeje bashkëpunuese dhe të unifikuar ndërmjet institucioneve në Kosovë dhe Shqipëri, duke theksuar se harmonizimi më i ngushtë dhe veprimi i përbashkët mund të rrisin koherencën për organizatat e diasporës dhe të forcojnë ndikimin e përgjithshëm të përpjekjeve për angazhimin e diasporës. Në tërësi, seanca pasqyroj një angazhim të përbashkët për bashkëpunim më të drejtpërdrejtë, transparent dhe praktik ndërmjet organizatave të diasporës dhe institucioneve publike në Kosovë dhe Shqipëri.



### 3. REZULTATET DHE NDIKIMI

#### 3.1 Rezultatet



#### 3.2 Rezultatet e menjëhershme

- Rrjetëzim i forcuar ndërmjet pesë organizatave partnere të diasporës shqiptare në Gjermani
- Interes i lartë për aktivitete të përbashkëta ndërmjet përfaqësuesve të diasporës në kuadër të MEG
- Bashkëpunime të reja të iniciuara (bazuar në anketë)
- Dukshmëri e lartë e GIZ/MEG dhe e rrugëve të financimit për diasporën

Kontributi i Konferencës:

- Empowered diaspora capacities for project design/funding Rritje e angazhimit të organizatave të diasporës
- Transferim i njohurive përmes paneleve tematike
- Dialog ndërkulturor me komunitetet partnere të MEG
- Fuqizim i kapaciteteve të diasporës për dizajnimin e projekteve dhe qasjen në financim



---

## 4. PËRSHTYPJET E Pjesëmarrësve

### 4.1 Rezultatet nga Anketa



Gjithsej **71** pjesëmarrës plotësuan anketën

Vlerësimi i përgjithshëm **83.1%** “Shumë të kënaqur”

Mundësitë për rrjetëzim **92.96%** i vlerësuan si “të mira” ose “shumë të mira”

Potencial për bashkëpunime të reja **73.24%** u përgjigjën “Po”

### 4.2 Vlerësimi cilësor

Pjesëmarrësit vlerësuan veçanërisht:

- Cilësinë e lartë të folësve
- Dimensionin ndërkulturor dhe ndërkombëtar
- Balancën mes kulturës, identitetit, teknologjisë dhe edukimit
- Profesionalizmin e lartë organizativ nga GERMIN

Ndërsa rekomanduan përmirësime në:

- Disiplinën e menaxhimit të kohës në agjendë
- Më shumë sesione interaktive (fishbowl, punëtori, grupe të vogla pune)
- Rritjen e dukshmërisë për organizatat e diasporës (stenda/booths)
- Përgatitje më të fortë të moderatorëve për disa panele

---

### 4.3 Testimonials

“Ne synojmë ta operacionalizojmë këtë bashkëpunim për të hartuar dhe akredituar një program master profesional që certifikon mësuesit e gjuhës shqipe në diasporë në Universitetin e Shkodrës..”

kontribues i jashtëzakonshëm për universitetin tonë, përmes memorandumit të mirëkuptimit që nënshkruam së bashku disa muaj më parë. Besoj se pas kësaj konference do të jemi në gjendje ta operacionalizojmë këtë marrëveshje bashkëpunimi në një mënyrë që na lejon të realizojmë projektin tonë — një plan afatmesëm dhe afatgjatë: hartimin dhe licencimin e një programi master profesional në mësimdhënie apo arsim, në mënyrë që të certifikojmë gjuhën shqipe dhe mësuesit e diasporës në Universitetin e Shkodrës”.

**Prof. Tonin Gjuraj, Rektor i Universitetit të Shkodrës**

“Jam shumë i lumtur që jam këtu sot, të ndiej atmosferën dhe energjinë e ngrohtë. Po ashtu jam shumë i kënaqur që komuniteti shqiptar i mbështet fëmijët në shkollë dhe që ne mund të ofrojmë një kurs të mirë të gjuhës së trashëguar në shkollat tona.”

**Mostapha Bouklouâ, Drejtor i Divizionit “Integrimi përmes Arsimit” në Ministrinë e Arsimit, Nordrhein-Westfalen (NRW)**

“Konferenca Diaspora Flet është ngjarja më e madhe që bashkon aktorë nga diaspora dhe organizata të ndryshme...”

“Konferenca Diaspora Flet është ngjarja më e madhe që bashkon aktorë nga diaspora dhe organizata të ndryshme për të diskutuar angazhimin dhe bashkëpunimin me vendet e origjinës — Kosovën dhe Shqipërinë. Për ne, si

GIZ, ishte një kënaqësi dhe rezultoi të ishte një ngjarje shumë e suksesshme, me shumë panele diskutimi dhe tema të larmishme, si dhe me rezultate konkrete që shpresojmë të realizohen së shpejti dhe të shndërrohen në aktivitete të prekshme.”

**Xhelal Derguti, Koordinator për Diasporën, GIZ Kosova, Prishtina**

“Për mua, kjo është hera e parë që marr pjesë në konferencën Diaspora Flet dhe mikpritja ka qenë jashtëzakonisht e ngrohtë — plot entuziazëm dhe me shumë të rinj. Veçanërisht paneli i parë, i fokusuar në kulturë, identitet dhe integrim, vërtet i ndezi zemrat e pjesëmarrësve dhe na përballi me sfida të reja: cili është obligimi ynë dhe çfarë duhet t’u lëmë brezave që vijnë”

**Enela Markja, Member of Diaspora Organization “Dija e.V.”, Munich**

---

“Jam shumë e lumtur që jam këtu. Ka shumë njerëz të mirë dhe ambiciozë. Është një mundësi e shkëlqyer për të diskutuar disa çështje që na kanë prekur dhe disa gjëra që gjithmonë kemi dashur t’i arrijmë apo t’i ndryshojmë për Kosovën nga këtu. Duhet ta pranoj se folësit e kësaj konference nuk më ishin të njohur më parë, por jam e kënaqur që po i njoh këtu — duke dëgjuar, mësuar dhe zbuluar diçka të re.”

**Rreze Hoxha, Pjesëmarrëse, German-American Institute Heidelberg**

---

“Ishte një mundësi shumë e mirë për të takuar kaq shumë njerëz nga vende të ndryshme dhe nga pjesë të ndryshme të Gjermanisë, si dhe kaq shumë organizata që po bëjnë një punë kaq të mirë.”

**Lindita Arapi, Journalist, presenter, author, Deutsche Welle, Bonn**

---

“Dua ta falënderoj Germin dhe UraCult për ftesën në këtë konferencë të mrekullueshme Diaspora Flet. Është nder për mua të jem mes njerëzve të mi nga Shqipëria, Mali i Zi dhe Kosova.”

**Nermina Kukaj, Actress, Director, Writer, Düsseldorf**

---

## 5. SFIDAT DHE MËSIMET E NXJERRA

Konferenca Diaspora Flet 2025, prodhoi një sërë njohurish operationale dhe programatike. Këto mësimë janë thelbësore për përmirësimin e edicioneve të ardhshme të Diaspora Flet, si dhe për forcimin e ekosistemit më të gjerë të angazhimit të diasporës të mbështetur nga MEG.

### 5.1 Mësimet Operacionale

A. Çfarë funksionoi mirë

#### • Logjistika dhe menaxhimi efikas i vendit

Konferenca përfitoi nga një logjistikë pa probleme, duke përfshirë regjistrimin e mirëorganizuar, qarkullimin efikas të pjesëmarrësve dhe vendosjen e duhur të sallave. Pjesëmarrësit vazhdimisht vlerësuan vendin e ngjarjes dhe profesionalizmin e koordinimit në vend.

#### • Komunikim i fortë i brendshëm dhe përgatitje e kujdesshme

Koordinimi i GERMIN me organizatat partnere të diasporës në Gjermani dhe ekipet GIZ–MEG në Kosovë dhe Shqipëri rezultoi jashtëzakonisht efektiv. Pesë takime të strukturuar para konferencës vendosën pritshmëri të qarta mbi dizajnin e agjendës, temat e paneleve, rezultatet e sesioneve dhe kërkesat teknike.

#### • Cilësi e lartë e materialeve audio-vizuale dhe të markimit (brandingut)

Cilësia e lartë e fotografive, videove përmbledhëse dhe materialeve vizuale të markuara rriti ndjeshëm dukshmërinë e ngjarjes. Kjo forcoi perceptimin e profesionalizmit dhe ndikimin e komunikimit pas ngjarjes.

B. Sfidat e hasura

#### • Menaxhimi i kohës dhe respektimi i agjendës

Disa panele tejkaluan kohën e caktuar për shkak të angazhimit të lartë të audiencës, duke zvogëluar fleksibilitetin e orarit.

#### • Mungesa e një mekanizmi të strukturuar për përputhje paraprake

Një nga boshllëqet kryesore operative të identifikuar gjatë konferencës ishte mungesa e një platforme ose vegje digjitale për përputhje para ngjarjes, e cila do të kishte mundësuar që pjesëmarrësit, organizatat e diasporës, panelistët dhe aktorët institucionalë të lidhen paraprakisht bazuar në interesa të përbashkëta, fusha ekspertize dhe qëllime bashkëpunimi. Për shembull, një direktori online e thjeshtë, një formular për identifikimin e interesave, një algoritëm për përputhje apo një modul mesazhimi mes pjesëmarrësve do ta kthente rrjetëzimin nga një proces spontan në një qasje më të organizuar, më të barabartë dhe më të fokusuar në rezultate. Kjo do ta afronte më



---

shumë me objektivat e konferencës dhe me fokusin e programit MEG për bashkëpunim të orientuar nga rezultate konkrete.

## **5.2 Mësimet programore**

### **A. Nevoja për format më interaktiv dhe përfshirës – përfshirë ngjarjet dytësore**

Një mësim kryesor programor nga Diaspora Flet 2025 është nevoja për të plotësuar panelet me format interaktive të strukturuar dhe ngjarje dytësore të dedikuara, për të thelluar pjesëmarrjen dhe për të nxitur iniciativa më të prekshme pas ngjarjes.

Pjesëmarrësit shprehën interes për format që shkojnë përtej diskutimeve klasike të paneleve dhe lejojnë pjesëmarrje aktive, si tryeza sektoriale, punëtori bashkë-krijimi, dhe ngjarje/ndërveprime paralele. Këto qasje njihen gjithnjë e më shumë si praktikë e mirë në konferenca ndërkombëtare, pasi i transformojnë pjesëmarrësit nga dëgjues pasivë në bashkë-krijues dhe shfrytëzojnë “inteligjencën kolektive” të pranishme në sallë.

### **B. Nevoja për një “Panair të Organizatave të Diasporës”**

Pjesëmarrësit theksuan vlerën e krijimit të një hapësire të strukturuar ku organizatat e diasporës mund të prezantojnë punën e tyre, të ekspozojnë iniciativa dhe të zhvillojnë diskutime të synuara për rrjetëzim. Kjo do të rrisë ndjeshëm mundësitë për bashkëpunim.


### **C. Kërkesa për transmetim të drejtpërdrejtë dhe qasje hibride**

Anëtarët e diasporës që nuk mund të merrnin pjesë fizikisht kërkuan qasje në distancë në panele. Ofrimi i transmetimit të drejtpërdrejtë ose i veçorive virtuale interaktive do të rrisë përfshirjen dhe do të zgjerojë ndikimin e programit MEG.



---

## 6. FOTOGRAFI (Kliko [këtu](#) për albumin e konferencës)





---

## 7. REKOMANDIMET

### 7.1 Pilotimi i një programi të strukturuar, shumëbrezor të angazhimit kulturor

Diskutimet gjatë Panelit të Kulturës nxorën në pah nevojën për vazhdimësi të qëndrueshme kulturore ndër breza, veçanërisht tek të rinjtë e diasporës që kanë lindur ose janë rritur në Gjermani. U theksua se identiteti, gjuha dhe ndjenja e përkatësisë kulturore forcohen më së miri kur të rinjtë angazhohen në mënyrë aktive në procese artistike dhe kulturore të strukturuar, e jo përmes ekspozimit sporadik apo aktiviteteve të izoluara të tipit event.

#### Propozimet:

- Hartimi i një programi pilot 6–12 mujor në disa qytete të Gjermanisë, i cili kombinon:
  - Punëtori krijuese (arte pamore, performancë, fotografi, tregim rrëfimesh);
  - Elemente të gjuhës dhe trashëgimisë kulturore;
  - Shkëmbim ndërbrezor ndërmjet artistëve të diasporës të konsoliduar dhe
  - Një prezantim publik përmbyllës (ekspozitë, shfaqje filmike ose performancë).
- Zbatimi të bëhet në partneritet me organizata kyçe kulturore të diasporës dhe shkolla me bazë në komunitet (p.sh. URACul e.V., ODA e.V., OAS e.V. LAPSH, KASH etj).
- Të shfrytëzohet mbështetja e MEG për koordinim, ekspertizë në lehtësim (fasilitim) dhe grante të vogla për materiale kulturore dhe kostot e punëtorive.

#### Rezultatet e pritshme:

- Forcim dhe qëndrueshmëri më e madhe e transmetimit ndërbrezor të identitetit kulturor.
- Rritje e angazhimit të të rinjve të diasporës të gjeneratës së dytë dhe të tretë.
- Bashkëpunim kulturor i avancuar ndërmjet organizatave të diasporës dhe institucioneve.
- Një model i zbatueshëm që mund të replikohet ose të zgjerohet në qytete të tjera të Gjermanisë në ciklet e ardhshme të Diaspora Flet ose në konferenca të ngjashme.

---

## 7.2 Realizimi i një hulumtimi gjithëpërfshirës mbi gjendjen aktuale të Organizatave të Diasporës shqiptarfolëse në Gjermani

Bazuar në diskutimet e zhvilluara gjatë konferencës, konsiderojmë se paraqitet si domosdoshmëri realizimi i një studimi të strukturuar për të vlerësuar gjendjen aktuale të organizatave të diasporës shqiptarfolëse në Gjermani. Ky hulumtim do të ofrojë një pasqyrë të qartë dhe të sistemuar mbi profilet e organizatave, kapacitetet e tyre organizative, burimet e financimit, strukturat e anëtarësisë, fushat e veprimtarisë, si dhe sfidat operationale me të cilat ato përballen.

**Arsyetimi:** Panelet 2 dhe 5, si dhe seanca institucionale e Ditës 3, theksuan me insistim mungesën e një hartëzimi të përditësuar dhe të bazuar në prova të organizatave të diasporës në Gjermani. Edhe pse komuniteti i diasporës shqiptare në Gjermani dhe më gjerë konsiderohet një nga më aktivët, gjendja aktuale e organizatave shqiptarfolëse mbetet e fragmentuar dhe e paqartë, si për institucionet e vendeve të origjinës, ashtu edhe për partnerët ndërkombëtarë.

Një hulumtim sistematik do të gjeneronte një bazë të fortë njohurish që do të mbështeste:

- Hartimin e politikave të synuara në vendet e origjinës dhe pritjes,
- Planifikimin strategjik nga rrjetet dhe asociacionet e diasporës,
- Programet e përshtatura për donatorë dhe partnerë në zhvillimin e kapaciteteve,
- Koordinimin më të mirë ndërmjet organizatave.

### Propozimet:

- Hartimi i një kornize hulumtimi bazuar në metodologjitë ndërkombëtare të përdorura për analizën e organizatave të diasporës (p.sh., regjistrim organizativ, hartëzim i akterëve kyç).
- Realizimi i një ankete për 200–300 organizata dhe grupeve të caktuara të diasporës në Gjermani.
- Mbajtja e fokus grupeve me udhëheqës nga qytetet kryesore në Gjermani.
- Hartimi i një raporti publik që përfshin tipologjitë e organizatave, analizën e nevojave, sfidat, boshllëqet në financim dhe fushat e mundësive.

### Rezultatet e pritshme

- Njohuri të qarta dhe të bazuara në të dhëna mbi ekosistemin e organizatave të diasporës.
- Identifikimi i sektorëve prioritar për mbështetje nga MEG dhe institucionet e vendeve të origjinës (arsim, kulturë, të rinj, biznes, integrim).
- Prova dhe informacion për strategji afatgjata dhe për hartimin e politikave të ardhshme për diasporën



### 7.3 Forcimi i shkëmbimeve ndërkombëtare ndërmjet organizatave të diasporës përmes një modeli të strukturuar të Fellowshipit/Exchange Cross-Network

Bazuar në diskutimet gjatë Panelit 2 – Përvoja krahasuese ndërkombëtare të projekteve të suksesshme të diasporës në konferencë, dhe mbështetur nga folësit dhe pjesëmarrësit, rezulton se ekziston një nevojë për një model të strukturuar për shkëmbimin ndërkombëtar të ekspertizës ndërmjet organizatave të diasporës. Ky model do t'u mundësojë organizatave të diasporës në Gjermani të lidhen në mënyrë sistematike, të mësojnë dhe të rrisin inovacionin së bashku. Duke u bazuar në Bordin Këshillimor të Diasporës të Programit MEG (Diaspora2030), Diaspora Flet mund të shërbejë si një kuadër më i gjerë, multidisiplinor dhe bashkëpunues për shkëmbime ndërkombëtare.

**Arsyetimi:** Folësit theksuan se organizatat e diasporës shqipfolëse në Gjermani përballen me sfida që pasqyrojnë ngushtësisht ato të komuniteteve të diasporës nga Nepali, Ekuadori, Kolumbia, Ukraina, Gana dhe shtete të tjera në kuadër të MEG. Pjesëmarrësit shprehën interes të fortë për vazhdimin e këtyre shkëmbimeve përtej kornizës së konferencës, duke nënvizuar se dialogjet ad-hoc nuk janë të mjaftueshëm — është e domosdoshme krijimi i një mekanizmi që siguron vazhdimësi, transferim të rregullt të njohurive dhe bashkëpunim më të thelluar

#### Modeli i strukturuar i shkëmbimit do të mundësonte:

- Shkëmbimin e praktikave të testuara më parë, metodologjive organizative dhe qasjeve të qeverisjeve,
- Transferimin e inovacionit ndërmjet rrjeteve të diasporës që veprojnë në kontekste sociale dhe institucionale të krahasueshme,
- Mësimin nga ekosisteme globale të diasporës për të forcuar angazhimin me institucionet e vendeve të origjinës,
- Ndërtimin e marrëdhënieve afatgjata, iniciativave të përbashkëta dhe zgjidhjes bashkëpunuese të problemeve.

#### Propozimet

- Bashkë-dizajnimi i një modeli shkëmbimi mes diasporave me organizatat e përfaqësuara në Diaspora Flet, duke siguruar pronësi të përbashkët dhe relevancë të drejtpërdrejtë.
- Krijimi i programeve të mobilitetit dhe shkëmbimit në formë fellowship, që u mundësojnë stafit dhe drejtuesve të organizatave të mësojnë nga kolegë në vende të tjera.
- Formimi i grupeve tematike afatshkurtra për mësim mes kolegëve, të fokusuara në integrim, organizim të të rinjve, modele financimi, kulturë, sipërmarrje dhe advokim politikash.

#### Rezultatet e pritshme

- Bashkëpunim ndërkombëtar i qëndrueshëm dhe mësim i strukturuar ndërmjet bashkëmoshatarëve mes organizatave të diasporës.

- Rritje e integritetit dhe e kompetencave ndërkulturore në shoqëritë pritëse, përmes ekspozimit ndaj përvojave globale të diasporës.
- Angazhim më i koordinuar dhe me ndikim më të madh me institucionet në vendet e origjinës.

#### 7.4 Zhvillimi i një Platforme Digjitale Interaktive për Organizatat e Diasporës në Gjermani

Të krijohet një platformë digjitale, interaktive, që lidh të gjitha organizatat e diasporës shqipfolëse në Gjermani, duke ofruar dukshmëri, mjete komunikimi dhe një kalendar të përbashkët aktivitetesh.

**Arsyetimi:** Ky ishte rekomandimi më i përsëritur gjatë gjithë konferencës. Aktualisht, qindra organizata të diasporës veprojnë në mënyrë të pavarur, me mundësi të kufizuara për t'u vënë re, kontaktuar apo për të bashkëpunuar. Ky fragmentim dobëson veprimin e përbashkët dhe pengon zhvillimin e iniciativave të përbashkëta.

Praktikat ndërkombëtare tregojnë se komunitetet e diasporës përfitojnë ndjeshëm nga qendra digjitale të centralizuara, të cilat përfshijnë:

- regjister digjital i organizatave të diasporës
- kalendarë aktivitetesh dhe ngjarjesh,
- arkiva burimesh,
- mjete për rrjetëzim, përputhje bashkëpunimi dhe komunikim.

Shembuj të tillë përfshijnë Irish Global Diaspora Directory, Armenian Diaspora Hub dhe Filipino Community Portals në BE. Ky rekomandim përputhet drejtpërdrejt me rekomandimin e parë dhe mund të zhvillohet paralelisht ose të ndërthuret me të, duke krijuar një bazë të përbashkët informacioni dhe bashkëpunimi për ekosistemin e diasporës në Gjermani.

#### Elemente të propozuara për platformën:

- Regjister i verifikuar i organizatave, me profile të plota, të dhëna kontakti dhe fusha tematike të veprimtarisë.
- Kalendar interaktiv i ngjarjeve, ku secila organizatë mund të publikojë aktivitetet e saj.
- Prezantim i projekteve dhe praktikave më të mira të angazhimit, në mënyrë të ngjashme me Diaspora2030.de, i shoqëruar me funksion mesazhesh ose formular kontakti për komunikim të drejtpërdrejtë.
- Qendër burimore për informacione mbi financime, trajnime dhe programe institucionale. jo platformë mund të zhvillohet si një sistem i lehtë dhe i shkallëzueshëm, i ndërtuar mbi teknologji ekzistuese (p.sh. një hub i bazuar në WordPress, një direktori në Airtable, ose një bazë të dhënash e personalizuar në Webflow).

#### Rezultatet e pritshme

- Rritja e dukshmërisë për të gjitha organizatat e diasporës në Gjermani.

- Forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet organizatave.
- Lehtësim i qasjes për institucionet për të shpalosur mundësitë e tyre.
- Integrim më i madh i iniciativave të diasporës në nivel lokal dhe federal.

## 7.5 Forcimi i mësimin plotësues të gjuhës shqipe në Gjermani

Të zhvillohet dhe të mbështetet një model i koordinuar për mësimin plotësues të gjuhës së origjinës në Gjermani, i zbatuar përmes shoqatave të mësuesve të diasporës, organizatave lokale dhe partneriteteve me komunat gjermane, për të siguruar rezultate afatgjata në gjuhësi, arsim dhe integrim për të rinjtë e diasporës.

**Arsyetimi:** Diskutimi në panel mbi rolin e gjuhës në integrim tregoi se shumë fëmijë me origjinë shqiptare ose të tjera migrante kanë qasje të kufizuara në mësimin e strukturuar të gjuhës amtare. Hulumtimet tregojnë se fëmijët migrantë që nuk zhvillojnë aftësi të forta në gjuhën e tyre të origjinës shpesh hasin pengesa shtesë në të mësuarit e gjuhës së vendit pritës, gjë që mund të ndikojë negativisht në performancën e tyre arsimore dhe integrimin afatgjatë në karrierë. Njohurit e avancuara të gjuhës amtare forcojnë zhvillimin kognitiv, mbështet alfabetizimin dhe aftësitë në gjuhën lokale, forcon identitetin dhe besimin në vetvete, faktor të cilat janë thelbësorë për një integrim të suksesshëm social dhe ekonomik në Gjermani.

### Propozimet

- Mbështetje për shoqatat e mësuesve të diasporës (p.sh., KASH, LAPSH) për të ofruar klase shtesë të standardizuara të gjuhës amtare.
- Përfshirja e institucioneve të vendit të origjinës dhe institucioneve të arsimit të lartë për trajnimin e mësuesve dhe ofrimin e materialeve digjitale të mësimin.
- Partneritet me shkollat dhe komunat gjermane për të ofruar klase shqipe gjatë fundjavave ose pas shkollës.
- Zhvillimi i një platforme të thjeshtë “Gjej Klasa”, që u lejon familjeve të gjejnë kurset e gjuhës shqipe pranë vendbanimit.
- Zhvillimi i metodave për ta bërë mësimin e gjuhës më tërheqës, për të rritur pjesëmarrjen e nxënësve.

**Rezultatet e pritshme:** Përmirësim i aftësive dygjuhëshe, forcim i identitetit dhe i rezultateve të integrit për të rinjtë e diasporës, dhe krijimi i një modeli të shkallëzueshëm që mund të përfitojë edhe komunitete të tjera me gjuhë të trashëguara (heritage languages).

## 7.6 Përforsimi i komunikimit dhe koordinimit ndërmjet organizatave të diasporës dhe Institucioneve të vendeve të origjinës

Të krijohet një kuadër i koordinuar për komunikim dhe angazhim ndërmjet organizatave të diasporës në Gjermani dhe institucioneve përkatëse në Kosovë dhe Shqipëri, duke siguruar: shpërndarje të qëndrueshme të mundësive të financimit, udhëzime të qarta mbi procedurat e aplikimit, dhe rrugë të lehta e të qasshme për organizatat dhe profesionistët e diasporës për t'u angazhuar me institucionet e vendeve të origjinës.

**Arsyetimi:** Qëllimi kryesor i ftesës së institucioneve nga Kosova dhe Shqipëria në Diaspora Flet 2025 ishte të informonin organizatat e diasporës mbi skemat ekzistuese të financimit, procedurat e aplikimit dhe mundësitë e angazhimit. Prezantimet u pritën shumë mirë, dhe shumë pjesëmarrës vlerësuan mekanizmat konkrete të mbështetjes financiare për iniciativa kulturore, arsimore dhe komunitare. Disa përfaqësues të diasporës thanë se më parë nuk kishin njohuri për këto programe dhe tani janë të motivuar për të eksploruar aplikime të ardhshme.

Në të njëjtën kohë, seanca institucionale evidentoi sfida të rëndësishme: organizatat e diasporës shpesh marrin informacione të fragmentuara ose të paplota, përballen me rrugë të paqarta për të aksesuar financime, dhe nuk kanë një mekanizëm të strukturuar për të bërë pyetje pas prezantimeve ose për të marrë mbështetje teknike.

Gjithashtu, një vëzhgim kyç i përsëritur ishte se diaspora shqipfolëse në Gjermani funksionon si një komunitet i integruar dhe jo i ndarë sipas kufijve kombëtarë. Komunikimi i ndarë dhe jo i koordinuar ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë rrezikon të krijojë konfuzion dhe dyfishim të përpjekjeve. Pjesëmarrësit theksuan fuqimisht nevojën që të dy vendet të koordinojnë aktivitetet e tyre dhe të mbështesin së bashku projektet e udhëhequra nga diaspora, që sjellin përfitim të ndërsjellë.

Pjesëmarrësit shprehën dëshirën që institucionet të njohin organizatat e diasporës si partnerë thelbësorë dhe të përmirësojnë mekanizmat e partneritetit të strukturuar. Shumë organizata të diasporës perceptojnë një mungesë të konsiderueshme: ndërsa strukturat e bashkëpunimit në Gjermani janë gjithnjë e më të hapura për të shfrytëzuar ekspertizën e diasporës, programet politike dhe institucionet në vendet e origjinës kanë qenë të pasigurta në përdorimin e plotë të potencialit të këtyre organizatave. Për të mbushur këtë boshllëk, është thelbësore të përmirësohet shpërndarja e informacionit dhe, po ashtu, të forcohet një angazhim më i thellë politik dhe programor. Kjo do të sigurojë që organizatat e diasporës të integrohen si partnerë formalë dhe të njihen si pikë kontakti kyçe për dizajnimin dhe zbatimin e iniciativave bashkëpunuese.

Forcimi i komunikimit dhe koordinimit jo vetëm që do të përmirësojë gatishmërinë e organizatave të diasporës për të aplikuar për financime, por gjithashtu do të rrisë besueshmërinë institucionale dhe angazhimin afatgjatë



---

### 7.7.1 Proposals for Strengthening Engagement and Support for the Diaspora

1. Krijimi i një “Udhëzuesi të Konsoliduar për Angazhimin dhe Financimin e Diasporës” që përmbledh:
  - të gjitha skemat e granteve,
  - kriteret e pranueshmërisë,
  - afatet e aplikimit,
  - procedurat e vlerësimit, dhe
  - pikat e kontaktit nga të dy vendet, Kosova dhe Shqipëria.
2. Mbajtja e sesioneve të informimit online çdo tremujor, ku institucionet prezantojnë mundësitë e ardhshme të financimit, sqarojnë procedurat e aplikimit dhe përgjigjen pyetjeve të pjesëmarrësve.
3. Krijimi i një “helpdesk” të përbashkët Kosovë–Shqipëri (email ose sistem ticket-i) për të ofruar përgjigje të shpejta mbi kërkesat për financim dhe mundësitë e angazhimit profesional.
4. Zhvillimi i një mekanizmi të strukturuar për angazhimin profesional të diasporës, duke përfshirë thirrje për ekspertë, programe mentorimi, skema për ligjërues vizitorë dhe mikrokonsulenca.
5. Ofrimi i mbështetjes së synuar për gatishmërinë e aplikimit për organizatat e diasporës, duke përfshirë: udhëzime mbi hartimin e projekteve, planifikimin e buxhetit, kërkesat për monitorim dhe vlerësim, dhe pritshmëritë për përputhshmëri me rregullat.

#### Rezultatet e pritshme

- Rritje e ndërgjegjësimit dhe përdorimit të programeve të financimit të disponueshme nga organizatat e diasporës.
- Përmirësim i gatishmërisë dhe kapaciteteve organizative për aplikim të suksesshëm.
- Rritje e transparencës dhe përgjegjshmërisë institucionale ndaj nevojave të diasporës.
- Reduktim i dyfishimeve dhe konfuzionit përmes komunikimit të harmonizuar Kosovë–Shqipëri.
- Një qasje institucionale e koordinuar, e cila përputhet me identitetin e unifikuar dhe funksionimin e diasporës shqiptarfolëse në Gjermani.

#### Rezultate të pritshme shtesë për Diaspora Flet dhe organizatat e diasporës:

- Rritje e pronësisë, motivimit dhe llogaridhënies midis organizatave të diasporës si bashkë-krijuese të Diaspora Flet.
- Pjesëmarrje më e larmishme dhe e balancuar gjeografikisht.
- Zbatim më efektiv dhe inovacion në pika specifike programore, duke ruajtur koherencën strategjike të përgjithshme.
- Rritje e qëndrueshmërisë dhe shkallëzueshmërisë së modelit të konferencës, që mund të riprodhohet në të ardhmen edhe në vende të tjera.

---

## 8. KONKLuzionet

Konferenca *Diaspora Flet 2025* në Gjermani arriti me sukses objektivat e saj dhe konfirmoi rëndësinë e vazhdueshme të angazhimit të diasporës si një kontribut strategjik për migracionin e orientuar drejt zhvillimit. Ngjarja ofroi një platformë të strukturuar për dialog midis organizatave të diasporës, institucioneve dhe organizatave partnere të vendeve të MEG/GIZ. Ajo gjeneroi njohuri të vlefshme mbi nevojat organizative, fushat e mundshme të bashkëpunimit dhe barrierat sistemike që kërkojnë vëmendje afatgjatë.

Gjatë tre ditëve, konferenca fasilitoj shkëmbime të cilësisë së lartë mbi kulturën, transferimin e njohurive, inovacionin, arsimin dhe bashkëpunimin institucional. Niveli i pjesëmarrjes dhe thellësia e diskutimeve konfirmuan se diaspora shqiptarfolëse, si dhe grupe të tjera diasporash në Gjermani, funksionojnë si ekosisteme të ndërlidhura me potencial të konsiderueshëm për të kontribuar në kohezionin social në Gjermani dhe në proceset zhvillimore në vendet e tyre të origjinës. Pjesëmarrësit shprehën qartë nevojën për: Më shumë shkëmbime dhe rrjetëzim; komunikim institucional më të koordinuar; përmirësim të qasjes në mësimin shtesë të gjuhës amtare; bashkëpunim më të gjerë ndërmjet diasporave, dhe programe më gjithëpërfshirëse, ndërgjeneruese.

Rezultatet e Diaspora Flet 2025 janë direkt të lidhura me programin MEG. Ngjarja forcoi rrjetet ndërmjet diasporave, identifikoi mundësi të reja për bashkëpunim transnacional, dhe ofroi rekomandime konkrete për përmirësimin e përgjegjshmërisë institucionale dhe dizajnin e programeve. Diskutimet gjithashtu nxorën në pah nevojën për mekanizma të koordinuar Kosovë–Shqipëri, që pasqyrojnë unitetin e diasporës dhe reduktojnë fragmentimin në ofrimin e shërbimeve.

Nga një këndvështrim strategjik, konferenca konfirmoi se angazhimi i diasporës jep rezultate më të mira kur mbështetet nga institucione të qarta, kanale komunikimi të qëndrueshme dhe kur ofrohet zhvillim i synuar i kapaciteteve të organizatave të diasporës. Rekomandimet e nxjerra nga panelet dhe seanca institucionale ofruan një udhërrëfyes të qartë për ndërhyrjet e ardhshme, duke filluar nga hulumtimet e bazuara në evidencë mbi organizatat e diasporës, shkëmbimet ndërkombëtare të strukturuar, mjetet digjitale për bashkëpunim, deri te përforcimi i mësimin të gjuhës amtare.

GERMIN shpreh mirënjohjen për partneritetin dhe udhëzimin e ofruar nga GIZ–MEG gjatë planifikimit dhe zbatimit të Diaspora Flet 2025. Duke u bazuar në themelet e forta të vendosura nga kjo ngjarje, GERMIN mbetet i përkushtuar për mbështetje të vazhdueshme të organizatave të diasporës, avancimin e bashkëpunimit institucional të koordinuar, dhe kontribuimin në objektiva të përbashkëta nën programin MEG.

Njohuritë e fituara gjatë Diaspora Flet do të ndihmojnë në krijimin e qasjeve më efektive, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme për angazhimin e diasporës.

---

## 9. RESOURCES

1. [Website dhe agenda](#)
2. [Linku i regjistrimit](#)
3. [Set i fotografive](#)
4. [Video përmbledhëse e Konferencës](#)
5. [Playlista Youtube](#)
6. [Përmbledhje mbi organizatat partnere](#)

**GERMIN** është organizatë joqeveritare e përkushtuar për fuqizimin dhe lidhjen e diasporës shqiptare në mbarë botën. Duke shfrytëzuar inovacionin, teknologjinë dhe rrjetet globale, GERMIN punon për të forcuar rolin e diasporës në zhvillimin social, ekonomik dhe demokratik të vendeve të origjinës. Duke vepruar si një urë lidhëse midis komuniteteve të diasporës dhe institucioneve vendore, organizata nxit bashkëpunimin, promovon shkëmbimin e njohurive dhe mbështet iniciativë që sjellin zhvillim të qëndrueshëm dhe ndikim afatgjatë.

### **Avokim dhe Diplomaci**

Ky program fokusohet në fuqizimin e diasporës përmes avokimit dhe përfshirjes në politika. GERMIN forcon lidhjet mes diasporës dhe institucioneve vendore, duke promovuar pjesëmarrjen e saj në proceset vendimmarrëse. Iniciativat kryesore përfshijnë projekte të zhvillimit të politikave, Konferencën Diaspora Flet, fellowship-e rajonale për të rinjtë, si dhe monitorimin e zgjedhjeve për të garantuar të drejtat e votimit dhe përfaqësimin e diasporës.

### **Angazhimi i Profesionistëve nga Diaspora**

GERMIN mundëson transferimin e njohurive dhe ekspertizës nga profesionistët e diasporës drejt vendeve të tyre të origjinës. Përmes platformave të rrjetëzimit, mentorimit dhe angazhimeve afatshkurtra, programi lidh profesionistët me institucione dhe organizata në Kosovë. Ai përfshin partneritete dhe projekte që mbështesin gratë në politikë, sipërmarrjen dhe zhvillimin e kapaciteteve në sektorë të ndryshëm, duke kontribuar drejtpërdrejt në zhvillimin socio-ekonomik.

### **Filantropia e Diasporës**

Ky program promovon dhurimin e strukturuar dhe me ndikim nga diaspora. Në bashkëpunim me Global Albanians Foundation, GERMIN mundëson mbledhje fondesh transparente dhe efikase për organizatat jofitimprurëse. Ai ndihmon në orientimin e kontributeve të diasporës drejt projekteve të zhvillimit social dhe ekonomik, duke reduktuar pengesat për donacionet ndërkufitare.

### **Të Rinjtë dhe Edukimi**

GERMIN punon për të lidhur arsimin me nevojat e tregut të punës duke angazhuar të rinj nga Kosova dhe diaspora. OriginAL është programi kryesor që ofron për të rinjtë e diasporës shqiptare një përvojë gjithëpërfshirëse edukative, kulturore dhe vullnetare në vendet e origjinës, duke i ndihmuar të rikthejnë lidhjen me rrënjët e tyre dhe të ndërtojnë marrëdhënie afatgjata.

### **Investimet e Diasporës**

Ky program synon të shndërrojë remitencat e diasporës në investime strategjike që nxisin rritjen ekonomike afatgjatë. GERMIN mbështet promovimin e investimeve, rrjetëzimin e bizneseve dhe partneritetet publiko-private. Përmes forumeve, iniciativave komunale dhe projekteve të synuara, ai lidh investitorët e diasporës me mundësitë lokale, duke nxitur krijimin e vendeve të punës dhe zhvillimin e qëndrueshëm.